



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.F.M "Eurolindi"  
Numri i biznesit - 80147040  
Pronar – Bujar AVDIMETAJ  
OSHMA ETV  
Pejë

Ref:1905/625/LIC/ni

## VENDIM

*për ripërtitjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes ETV, me seli në Pejë*

---

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. ETV është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes, me seli në Pejë. KPM, me datën 6 maj 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA ETV.
3. Me datën 6 maj 2019, ka skaduar afati i licencës së ETV, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtitjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 17 janar 2019, Departamenti i Licencimit i Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar, përmes e-mali, Ofruesin e Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes ETV, lidhur me skadimin e licencës në vitin 2019, si dhe me afatet dhe obligimet që parashihen me nenin 25 të Ligjit për KPM, për ripërtitje të Licencës së KPM-së.
5. Më 14 mars 2019, ETV ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtitje të Licencës së KPM-së.

1/2

## Arsyetimi

- OSHMA ETV, ka shfrytëzuar mundësin që i ofron Neni 25 i Ligjit të KPM-së dhe ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së, në pajtim me procedurat e përcaktuara administrative nga KPM.
- Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

*“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,*

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

## VENDIM

- Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 17 qershor 2019, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së ETV, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
- Licenca e KPM-së për OSHMA ETV do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 6 maj 2019.
- Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA ETV, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
- Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI  
Kryetar  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



17.06.2019  
datë